



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 28
Prishtinë, më 12 Maj 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203
Mbledhja filloi në orën 13:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Në mbledhje morën pjesë: Rustem Mustafa, Bojan Stojanovič, Shkumbin Demaliaj, Emrush Xhemajli, Gani Geci, Agim Veliu, Zafir Berisha dhe Ibrahim Selmanaj.

Mungoi: Melihate Termkolli, Eqrem Kryeziu, dhe Zylfi Merxha.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetari i komisionit.

Rendi i ditës

1. Takim me Ministrin e MPB-se, z.Zenun Pajaziti

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Takim me Ministrin e MPB-se, z.Zenun Pajaziti

Kryetari i Komisionit - tha, takimi me Ministrin e Punëve të Brendshme z. Zenun Pajaziti është në vijim të aktiviteteve të komisionit tonë lidhur me incidentin që ka ndodhur kohë më parë në policinë e Kosovës. Ne si komision kemi dal me vlerësimet

tona për këtë rast, kemi pasur takime edhe me staf të lartë të policisë së Kosovës në mungesë të drejtorit që nuk ishte atë ditë në komision. Sot e kemi këtu ministrinë për të prezantuar me vlerësimin e ministrit dhe përpjekjet për të zbardhur këtë rast sa më parë. Fillimisht komisioni do të dëgjojë nga ministri raportin e pastaj mund të ketë pyetje dhe komente nga anëtarët e komisionit.

Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme z.Zenun Pajaziti – tha, policia e Kosovës ende mbetet një nga institucionet më të besueshme në Kosovë. Mekanizmat e brendshëm të policisë po e kryejnë punën mirë. Përgjegjësia penale është më profesionale në gjetjen e kryerësve dhe ndëshkimin e tyre. Do të kërkojmë të ketë përgjegjësi menaxheriale. Asgjë nuk do të bëjmë që do ta cenonte të drejtën e dikujt. Më e rëndësishme është të përcaktojmë më shpejtë hetimet dhe të ketë përgjegjësi penale. Në dhomën e provave kanë humbur ato gjëra që dihen. Nuk ka humbje të dosjeve të caktuara. Askujt nuk i është bërë dëm më shumë se imazhit të Kosovës. Do të jemi transparent dhe do ti merrni me kohë informatat. Do të bashkëpunojmë me komisionin dhe ju të jeni kontribuues të themelimit të institucionit.

Emrush Xhemajli –Policia është tregues shumë i mirë deri para këtij rasti. Mirëpo rasti i fundit që ka ndodhur ka luhatur besimin e qytetarëve.

Gani Geci – z. Ministër, ju thatë se keni urdhëruar formimin e një Task Force. Ligji ia jep Inspektoratit të Policisë të menaxhojë objektet policore sepse rasti ka ndodhur brenda objektit të Policisë. Mirëpo Inspektorati është anashkaluar nga Policia dhe është formuar një Task Forcës për kryerjen e hetimeve. Unë dua të dijë se si bëhet kontrollimi i policëve gjatë hyrjes në objekt nga policët tjerë? A është e mundur që në dhomën e dëshmive janë vjedhur përditë nga pak sepse nuk është bërë ndonjë menaxhim i përditshëm. Në bazë të Kushtetutës së republikës së Kosovës, ne si Komision për Punë të brendshme dhe Siguri duhet të kërkojmë drejtpërdrejtë nga Ministri përgjegjës. Dhe mendoj se ju z.Ministër duhet të keni parasysh se cilat veprime do të merren për rastin në fjalë.

Zafir Berisha – Rastin që ka ndodh e kemi cilësuar si rast mjaft tragjik brenda një institucioni. Ne në komision kemi jap rekomandimet tona dhe kjo çështje duhet të shkojë në seancë. Ftojë që të gjithë të merren më seriozisht me çështjen që të kthejmë besimin e qytetarëve jo vetëm ndaj Policisë si institucion i ndjeshëm, por edhe ndaj institucioneve tjera.

Shkumbin Demaliaj – Sa i përket listës së inventarizimit që ka humb aty jam shumë skeptik dhe frikohem mos ka dalë ndonjë dëshmi e dëshmitarëve bashkë me atë material dhe dëshmitarët që janë në proces. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia konsideroj se kanë bërë gabim shumë të madh që e kanë bërë ngjarjen transparente në publik sepse është tregu një jo efikasitet nga ana e tyre. Përgjegjësia është e Drejtorit të përgjithshëm të Policisë

Ibrahim Selmanaj – Unë kërkoj që të caktohet një afat kohor nga organet zyrtare që sa më shpejtë të kryhet hetimi i rastit, sepse më vonë do të jetë mjaft vështirë që të zbardhet

rasti. Në të ardhmen të jemi më vigjilent dhe të mos merremi me pasojat po ti parandalojmë ato.

Bojan Stojanovič – Pavarësisht peripeccive të mëdha që kemi pas vitet e fundit Policia e Kosovës ka shënuar progres. Mirëpo në Policinë e Kosovës ekzistojnë disa qendra të cilat ende nuk mund të mbikëqyren, dhe për këtë arsye njerëzit kryejnë disa punë të cilat nuk janë në përputhshmëri me ligjin. Unë mund të përmendi një rast konkret, të mërkurën isha duke u kthyer nga Mitrovica, dhe më ndaloi policia, unë ju tregova Pasaportën diplomatike të Kosovës dhe polici filloi të bërtas duke pyetur se me çka merresha unë me drogë apo tregti armësh. Unë nuk jam përgjigjur sepse ndërkombëtarëve ju kam treguar se jam zyrtarisht, por sido që të jetë kjo për mua është një gjë e papranueshme nga ana e policisë sepse ata merren me sigurinë e qytetarëve. Pra, çdo qytetarë i Kosovës pavarësisht nga nacionaliteti, besimi etj duhet të fitojnë bindjen dhe të besojnë në policinë e Kosovës se ata merren me sigurinë në Kosovë, pavarësisht se a bëhet fjalë për serb apo nacionalitete tjera. Pra, policia e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme duhet të punojnë më shumë në mënyrë që t'i bindin qytetarët se shkelja e ligjit nuk do të lejohet.

Agim Veliu – Rasti që ka ndodhur është rast mjaft delikat. Gjithashtu edhe hetimet janë në fazën delikate dhe kjo është arsyeja që nuk mund ti thoni shumë këtij komisioni. Unë kam pritur që të na thuhet diçka më shumë për rastin në dhomën e dëshmive. Është një rast që e ka kompromentuar institucionin dhe për këtë arsye duhet një veprim më i shpejtë që të zbardhet ky rast. Është dashur që në fillim të fillohet me përgjegjësi morale pasi që ju t'i kishit identifikuar personat përgjegjës.

Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme z.Zenun Pajaziti – tha, do të mundohem të jem më konkret me shqetësimet që i keni ngrit ju. E para, më vjen keq nëse është kuptua që tek Drejtori i përgjithshëm ka një mos gatishmëri ti nënshtrohet kontrollit parlamentar. Unë me vonesë e kam kuptuar ftesën që i është bërë drejtorit të përgjithshëm të policisë sepse ai ka udhëtuar për në Mal të Zi me një delegacion. Gjithashtu tek përfaqësuesit që janë marrua me rastin kam vërejtur një shqetësim sepse kanë qenë në pyetje të dhëna delikate dhe nuk kanë ditur deri në çfarë mase të bëjnë raportim. Për këtë arsye kualiteti i informatës duhet kuptuar prej nevojës tyre që të bëhet një selektim se sa me profesionalizëm përpilimin e tyre. Është shumë e vërtetë siç tha z. Xhemajli që me këtë rast është luhatur besimi te qytetarët. Jam shumë i interesuar ta përballoj dhe të dal më i fortë se ata kriminel. U përmend raporti i Inspektoratit dhe në raport ka disa pika që policia ka reagua. Unë kam kërkuar nga Inspektorati që të bëhet raport për këto pika. Kam qenë i njoftuar jo vetëm për dhomës së provave por edhe për segmente tjera. Çështja e kompetencave që tha z.Geci, po mundohem ti respektoj ligjet, në asnjë pikë mos me tejkalua ligjin dhe nuk do të lejoj që të mos kryhen punët sidomos ato që janë në kompetencën time. Inspektorati nuk merret me hetimin e krimit po merret me çështjen nëse është bërë ndonjë shkelje procedurale. Ideja e krijimit të Task Forcës, është krijimi i një mekanizmi më të konsoliduar që hetimi të jetë më i kompletuar. Strukturat më të fuqishme të policisë po merren me rastin dhe kjo është ideja që mos ta heton një departament vetveten po të jetë një forcë më e madhe. Interesim i madh ka qenë nga të gjithë që të dihet rreth vlerës së lirave turke. Ju siguroj se nuk është vlerë e madhe siç është folur por ajo shumë prej 6.500.000 ka vlerë dhjetëra euro.

Gani Geci –_Ne e dimë se Inspektorati i policisë i përgjigjet Ministrin dhe raportet ia dërgon Ministrin. Inspektimi i asaj pasurie se çka është vjedh dhe shënimet tjera është dashur të bëhen nga Inspektorati e jo të formohet një Task Forcë.

Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme z.Zenun Pajaziti – tha, Inspektorati bën hetime për shkelje disiplinore për të gjithë zyrtarët e policisë si dhe bën inspektime në 14 fusha të menaxhmentit, duke përfshirë edhe menaxhimin e objektit. Mirëpo gjatë rastit që ka ndodh një vepër penale në policinë e Kosovës janë duke u zhvilluar hetimet e policisë dhe një nen në ligjin e Inspektoratit thotë nëse është duke u zhvillu ndonjë inspektim, në momentin që has në një vepër penale inspektimi ndërpritet dhe ju dërgohet policisë dhe prokurorisë në mënyrë që të mos bëhen dy hetime në të njëjtën kohë.

Meqenëse nuk kishte pika tjera për të diskutuar, kryetari i komisionit e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10.

Përgatiti:
Njësia Mbështetëse e Komisionit

Rrustem Mustafa
Kryetar i Komisionit